

V E N D I M
Nr.191, datë 6.4.2001

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.408, DATË 31.8.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PRIVATIZIMIN ME TENDER TË NDËRMARRJEVE
SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin, mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, dhe të vendimit nr.195, datë 20.3.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund të transformohen”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave, në kapitullin IX, bëhen këto shtesa:

a. Pas pikës 1, shtohet pika 1.1 me këtë përmbajtje:

“1.1. Për rastet kur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vendos për pavlefshmërinë e të gjitha ofertave të paraqitura, Agjencia Kombëtare e Privatizimit shpall një datë të re për paraqitjen e ofertave, në një afat jo më pak se 10 ditë, nga data e shpalljes së vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Njoftimi të përmbajë:

- Vendin, mënyrën, datën dhe orën e saktë për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.
- Njoftimin se kushtet e ftesës për tender, të publikuara në raundin e parë, nuk kanë ndryshuar.
- Shkaqet e njoftimit të datës së re për dorëzimin dhe hapjen e ofertave.”.

b) Pas pikës 2, shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1. Për rastet e mospjekës së tenderit procedurat fillojnë nga kapitulli I.”.

2. Ky vendim i shtrin efektet edhe për tenderat e publikuar, para hyrjes në fuqi të tij.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta